



BALLINA

LAJME ▾

VIDEO

BOTA

SPORT ▾

OPINION ▾

SHOWBIZ ▾

LIFESTYLE ▾

AUTO & TEK ▾

FUN ▾

ENGLISH ▾

U kap me substancë narkotike e armë brenda veturës, ndalohet për 48-orë një person në Prishtinë

LAJME



22/12/2024 09:27



Policia e Kosovës ka njoftuar se mbrëmë Antidroga ka ndaluar një veturë në rrugën “Fehmi Agani” në Prishtinë ku ishin tre persona.

Gjatë kontrollit sipërdorues tek tre personat dhe në veturë nuk është gjetur drogë e dyshuar, megjithatë për dyshimeve të ngjashme njëjtit janëshoqëruar në Stacionin Policor Qendra në Prishtinë për kontroll më të detajuar.

Gjatë kontrollit tek I.R. është gjetur një qese me pluhur ngjyrë e bardhë e dyshuar për narkotik të llojit kokainë me peshë 0.6 gramë si dhe në kuletën e tij është gjetur një qese me pluhur ngjyre të bardhe e dyshuar po ashtu e dyshuar si narkotik i llojit kokainë me peshë 0.6 gramë, ndërsa tek dy personat e tjerë nuk është gjetur asgjë e dyshuar.

Për të vazhduar kontrollin e detajuar të veturës është kërkuar ndihmë nga njësiti K-9 (njësiti me qen policor).

Policia njofton se i dyshuari porsa e ka parë qenin e Policisë ka treguar se në veturë nën mbishtesën e dorës në mes të shoferit dhe pasagjerit ka të fshehur një sasi të kokainës si dhe në dollapin poshtë timonit ka një revole.

“Kontrolli policor ka vazhduar dhe në këto dy vende të potencuara me lart nëveturë janë gjetur të fshehura: 29 qese të mbushura me pluhur ngjyrë të bardhë të dyshuar për narkotik të llojit kokainë me peshë 16.7 gramë, njërevole e tipit SIG SAUER, me një karikator, si dhe 21 fishek të kalibrit 9mm. Në kuletën e të dyshuarit po ashtu janë gjet të holla në vlerë prej570 euro dhe 50 franga”, thuhet në njoftim.

I dyshuari është dërguar në mbajtje.

“Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar në parandalimin e të gjitha veprimeve të kundërligjshme dhe masa rigoroze do të ndërmerren në bashkëpunim me organet e drejtësisë ndaj të gjithë atyre individëve apo grupeve që përfshihen në aktivitete kriminale”, thuhet në njoftim. **/Lajmi.net/**

Më shumë nga uebi

nativeGRAM
by LajmiMedia



Artikuj të ngjashëm



December 22, 2024

Dy persona të lënduar nga aksidenti tek Kodra e Trimave



December 22, 2024

Në këto dy pika kufitare pritjet zgjasin më shumë se një orë



December 22, 2024

Sali Berisha: Ndalimi i TikTokut, akt ekstrem censure



December 22, 2024

Publikohet lista e pasaportave më të fuqishme për 2024, Kosova e 55-ta



December 22, 2024

100 eurot e Qeverisë, Kica Xhelili: Mjaltë për blerje votash



December 22, 2024

Aksidenti trafiku tek Kodra e Trimave në Prishtinë, përfshihen disa automjete

lajmi.net

info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
Rr. Zenel Salihu nr. 28, zyrja nr. 5

RRJETET SOCIALE



Other Links

Fact-Checking Policy
Ethics Policy
Corrections Policy
Ownership & Funding Information
Editorial Team Information